



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 20.12.2019)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:40 dhe mbaroi në orën 13:47.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Maksim Qoku</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Medi Bici</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Ilir Toska</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami.*

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

*Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 20.12.2019*

2. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore të gjykatës së rrethit gjyqësor Lezhë dhe transferimin e përkohshëm të selisë së saj në ndërtesën e prokurorisë pranë kësaj gjykate”.

Maksim Qoku: Atëherë, përshëndetje, të nderuar anëtarë!

Sot jemi mbledhur për të shqyrtuar një çështje të vetme të rendit të ditës që ka të bëjë me rifillimin e veprimtarisë së shërbimeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe transferimin e përkohshëm të selisë së saj në ndërtesën e prokurorisë pranë kësaj gjykate.

Në vijim të ose të themi, shkak për këtë projektvendim është bërë materiali që ne kemi marrë nga kryetarja e Gjykatës Lezhë, e cila ka mbledhur edhe Këshillin e Gjykatës në lidhje me një vendimmarrje për vazhdimin e aktivitetit.

Në praktikën e dokumenteve që ka sjellë kjo e fundit, janë edhe dy aktet e ekspertimit (ajo e Bashkisë Lezhë dhe e Institutit të Ndërtimit). Në të dy aktet konstatohet fakti që ka dëmtime, ka çarje të kolonave dhe kërkojnë riparime të menjëhershme. Çka do të thotë që e pamundëson kryerjen e aktivitetit në këtë godinë.

Për këtë arsye, në informacionin që na ka sjellë, kjo e fundit na vë në dijeni që pas kërkesave në shkresat e ndryshme që i ka drejtuar pushtetit lokal edhe KLGJ-së për gjetjen e ambienteve alternative, ka mundësuar gjetjen e disa zyrave pranë godinës së prokurorisë. Kështu që ka kërkuar nga ne që të mund të marrim në konsideratë rifillimin e veprimtarisë për atë pjesë, në ato zyra që ka gjetur.

Po ka mendime...

Të kalojmë në miratimin e projektvendimit për rifillimin?

Atëherë, projektvendim “Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore të

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe transferimin e përkohshëm të selisë së saj në ndërtesën e prokurorisë pranë kësaj gjykate”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, i mbledhur sot më datë 20.12.2019, vendosi: Rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; Transferimin e përkohshëm të Selisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë në ndërtesën e ... (nuk lexohet fjala ‘prokurorisë’, pra në ndërtesën e prokurorisë) pranë kësaj gjykate, në ambientet e vëna në dispozicion prej saj; Në kushtet e ambienteve të kufizuara për ushtrimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore, Këshilli i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë të përcaktojë kategoritë e çështjeve gjyqësore për të cilat veprimtaria gjyqësore e kësaj gjykate rifillon menjëherë, duke vlerësuar dhe përcaktuar në vijimësi, sipas rastit dhe mundësisë, edhe çdo kategori tjetër çështjesh për të cilat veprimtaria e gjykatës rifillon; Ngarkohet Kryetari dhe Këshilli i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Nëse nuk keni gjë, mund ta votojmë?

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Maksim Qoku: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e këtij projektvendimi që referova sa më sipër. Kështu që të vihet në dijeni...

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe vënien në dijeni të kryetarit të gjykatës. Faleminderit!
Ditën e mirë!

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor